Numër: 01/282
Datë: 25.06.2021

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit nr. 28/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.06.2021 nxjerrë këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohen** Standardet e Profesioneve së bashku me të gjitha rekomandimet e paneleve të ekspertëve si standarde kombëtare të profesionit me kohëzgjatje 5 vjeçare, me këto emra dhe kode:

1. Udhëheqës/e i/e hotelit, me kodin 5121.02 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK;

2. Zjarrfikës, me kodin 5411 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Bazuar në kërkesën e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (KAAPRr/MASHT) për verifikimin e standardit të profesionit, KD i AKK, në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2021, ka shqyrtuar raportet e ekspertëve për standardet e profesioneve. Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve në proces të verifikimit të Standardeve të Profesionit gjatë realizimit të takimeve dhe vizitave me palët e interesit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë, sipas nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa

kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit kompetent, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

1. KAAPRr.-së;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK